



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 606/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092), në përbërje nga Vedat Poterqoi –Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga (OE) Operatori Ekonomik: "Dwh-Kosova Shpk" me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me instrument GPS", me nr. prok: 632-22-7865-1-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues –Komuna e Gjakovës, me datën 21.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar, ankesa e operatorit ekonomik, DWH-KOSOVA ShPK" me seli në Prishtinë, nr.606/22, e parashtruar kundër Njoftimit për Kontratë, lidhur, me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me instrument GPS", me nr. prok: 632-22-7865-1-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues –Komuna e Gjakovës.

Konfiskohet tarifa për ankesë e OE DWH-KOSOVA SHPK" me seli në Prishtinë konfom nenit 31 pika 5 të rregullores së punës së OSHP dhe mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 01.11.2022 ka pranuar ankesë nga OE DWH-KOSOVA Shpk", për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me instrument GPS", me nr. prok: 632-22-7865-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues –Komuna e Gjakovës, ankesë kjo e protokolluar nga OSHP me numër të protokollit 606/2022.

Me datë 27.10.2022 AK refuzon si të pa pabazuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik-OE DWH-KOSOVA Shpk”, për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me instrument GPS”, me nr. prok: 632-22-7865-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues –Komuna e Gjakovë.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Me datën 21.11.2022, OSHP-ë, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, i cili me datën 29 nëntor 2022, ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa e Operatorit Ekonomik ankues DWH-KOSVA SH.P.K të refuzohet si e pa bazuar,
- Ti lejohet Autoriteti kontraktues të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit sipas ndryshimeve të bëra në specifikimet teknike të datës 18.10.2022

Pretendimi ankimor nr. 1

OE ankues thotë se arsyeja e parë është që - AK ndryshon produktin nga ST "Manual" në ST "Motorizuar", pa ndryshuar buxhetin?!

Çuditërisht AK ndryshon produktin nga ST "Manual" në ST "Motorizuar", pa ndryshuar buxhetin?! Stacioni Total "IMOTORIZUAR" është një produkt tepër me i sofistikuar dhe evoluar nga MANUAL.

Këtu rezultojnë disa probleme:

- Nocioni i Motorizuar është nocion "PAUSHAL", që përdoret në "ZHARGON RRUGE", pra i pa definuar as si përmbajtje, as si performancë, as si funksionalitet dhe as si kualitet.
- Një instrument i tillë "HighEnd" shoqërohet me specifikime teknike tepër të qarta për të krijuar TRANSPARENCE dhe mos lejuar "FAVORIZIM" të një OE ose "DISKRIMINIM" të disa OE.
- Kalimi nga Stacioni Total Manual në të Motorizuar, përben një kapërcim financiar domethënës, por buxheti i tenderit ka mbetur çuditërisht i njëjtë?

Përgjigje në pretendimin ankimor 1

Lidhur me kërkesën stacioni total i motorizuar eksperti shqyrtues sqaron se nisur nga komentet e OE në fillim të kërkesës për rishqyrtim do të ishte se çfarë është i motorizuar dhe jo shqetësimi për buxhetin nëse është rritur apo jo. Pasi që për planifikimet e bëra buxhetore përgjegjës është Autoriteti Kontraktues për secilin aktivitet të prokurimit dhe në këtë fazë nuk mund të paragjykojmë që nuk do të ketë oferta brenda buxhetit andaj mendoj se nuk është në kompetencën tonë të shqyrtojmë planifikimin e buxhetit dhe po ashtu mendojmë se nuk është në kompetencën as të operatoreve ekonomik të ndikojnë tek autoritetet kontraktuese për rritje të buxheteve sipas dëshirave të tyre pasi që për aktivitetin në fjalë nuk janë pranuar ofertat për të parë se me çfarë buxheti mund të realizohet ky aktivitet. Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ankues është mjaft konfuz sepse në njërin anë thotë se AK nuk ka rritur buxhetin ndërsa në anën tjetër thekson se kërkesa për stacion total kërkon rritje të buxhetit për shkak se ky produkt është me i sofistikuar. Kjo është një kërkesë tek autoriteti që të rritet buxheti i kërkuar e cila mendoj se është në

kompetencë të AK-së të bëjë planifikimet buxhetore me të cilat ata mendojnë realizimin e projekteve.

Ne bazë të sqarimeve të specifikuara më lartë për mendimin e ekspertit shqyrtues pretendimi ankimor 1 është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor Nr. 2

Gps dhe stacioni total të jenë nga i njëjti prodhues

Kjo kërkesë është në kundërshtim me LPP 04/L-042, neni 1, pika 1 i cili kërkon "shfrytëzim të drejte të fondeve publike", ky rrit artificialisht dhe padrejtësisht çmimin.

Neni 1, pika 2, Neni 7 pika 1, të cilët kërkojnë "jo diskriminim" të OE dhe Prodhuesve. Kjo diskriminon prodhuesit, që plotësojnë kushtet më të mirë nga dy produktet, qoftë GPS ose ST.

neni 1, pika 3, Neni 7, pika 2, të cilët kërkojnë "kosto efektive", kurse kjo kërkesë ngushton garën "vetëm të ata, që kanë të dyja produktet nga i njëjti prodhues", duke përjashtuar prodhuesit, që ofrojnë një nga dy produktet "GPS ose ST"

neni 7, pika 3, që "ndalon kriteret për zgjedhje", që favorizojnë dhe diskriminojnë.

neni 7, pika 6, nën pika (i), që kërkon hapje të garës

neni 7, pika 6, nën pika (iii), që kërkon shmangen e kushteve diskriminuese

Neni 7, pika 6 nën pika (v), që kërkon të mënjanohej kërkesa dhe specifikime devijuese

Ne nënvizojmë për OPSH faktin, që sa herë që OSHP rrezon kërkesat dhe specifikimet entilgjore të AK, kjo futë me pas kërkesa të reja, përsëri në shkelje të ligjit. Kjo nxit dyshimin e bazuar, që një ose më shumë persona në OSHP kanë një agjendë personale në kundërshtim me agjendën e entit publik, që përfaqëson interesat e komunës, të cilat gjejnë mbështetje në LPP të përgatitur dhe nxjerrë nga ligjvënësi.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2

Lidhur me pretendimin ankimor, eksperti shqyrtues sqaron se sa i përket kërkesë se të gjitha pajisjet të jenë nga i njëjti prodhues eksperti shqyrtues mendon se nuk përmban shkelje ligjore sepse është në të drejtën e AK- se që të përcaktoj specifika të tilla si në rastin e IT pajisjeve që kërkohej "Brand Name" mirëpo nuk lejohet të behën favorizime të prodhuesve të ndryshëm. Operatori Ekonomik ankues nuk ka specifikuar ndonjë kërkesë teknike që është bërë ndonjë shkelje.

Ne baze të sqarimeve të specifikuara më lartë për mendimin e ekspertit shqyrtues pretendimi ankimor 2 i ankuesit është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor Nr. 3

Formatet e kërkuara txt, csv, dwg dhe shp

Vendimi i OSHP 380-389/22 pika 4 ku ne kemi kërkuar informacion me te gjere për ketë kërkesë indirekte, na jep te drejte, duke i ruajtur te drejtën edhe AK, qe te kërkoje ne përputhje me interesat e saj.

Shpjegim: kërkesat e AK txt, csv futen ne standardin e GPS dhe Stacionit Total dhe njihen ne gjuhe teknike ASCII (pra janë vlerat e 3 numrave X, Y, Z dhe te GPS shtohet edhe T, qe eshte koha matjes).

DWG është format vizatimor, i Software Auto desk, i cili (autodesk) ben pjese ne grupin e softwareve vizatimor, qe quhen CAD.

Po kështu baza e te dhënave CadastralMap, qe përdoret ne te gjitha komunat e Kosovës, nuk ka si premise as autodesk dhe aq me pak dwg, por punon me çdo program CAD, te cilt jane te shumte dhe shumica "FREE".

Ne i kemi kërkuar AK, ne emër te prodhuesit tone, qe te na beje me dije Nr. e licencës CadastralMap dhe Nr. e licencës Autodesk (ku është edhe nënprodukti dwg) për te pare specifikimet e software-it, qe disponon AK, qe ne te ofrojme zgjidhje maksimale.

Ne i kemi kërkuar AK te na beje me dije Tipin e GPS (kontrollerit), me ane te cilit ajo kryen punët e veta deri tani.

As kërkesa për licence te Autodesk, as kërkesa per licencën e CadastralMap dhe as kërkesa për GPS, qe përdor sot AK nuk na janë dhëna nga AK, por na janë refuzuar me fanatizëm.

Ne kemi dyshimin e bazuar, qe AK nuk disponon licence te Autodesk (pra as dwg) dhe CadastralMap është e njëjta baze te dhënash, e cila është e hapur për matjet, qe ofron cdo GPS dhe Stacion Total.

Nuk ka asnjë ent publik ne bote, qe ka interes qe te vendose një baze te dhënash (CadastralMap), qe është i hapur për një prodhues ne bote dhe i mbyllur për te tjerë, pasi do krijonte një varësi te pajustificuar. Te gjitha komunat ne Kosove punojnë prej vitesh me CadastralMap te hapur dhe nuk kane varësi për Autodesk dhe aq me pak për dwg.

Kjo përben nje kusht abuziv te AK, i cili bie ndesh me LPP ne disa nene (1, 7, 27) dhe me vehte frymën e ligjit. Ky është një rast për ekselencë, qe duhet provuar nëse kërkesat e AK janë abuzive dhe me qëllime te kundërta me vehte interesin publik te AK. Fshehja e informacionit përben shkak për dyshime te bazuara.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 3

Lidhur me pretendimin ankimor, eksperti shqyrtues sqaron se sa i përket kërkesë te formateve te kërkuara e cila është një kërkesë e specifikimeve teknike te kërkuara nga AK andaj eksperti shqyrtues mendon se është ne përgjegjësin e autoriteteve kontraktuese te i përgatisin specifikimet teknike ne harmoni me kërkesat dhe nevojat e tyre. Operatori Ekonomik ankues nuk ka prezantuar ndonjë dëshmi se ndonjë nga prodhuesit tjerë nuk posedon ndonjë format te kërkuara apo vetëm ndonjë prodhues i caktuar posedon te gjitha formatet e kërkuara.

Ne baze të sqarimeve të specifikuara me lartë për mendimin e ekspertit shqyrtues pretendimi ankimor 3 i ankuesit është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor Nr. 4

Software i GPS dhe ST te jete i hapur si e ka prodhuesi

Kjo kërkesë është diskriminuese, sepse prish barazinë në garë. Një Software i thjeshtë, i vjetër, si psh topcon/sokkia, merr përparësi abuzivisht dhe padrejtësisht ndaj një Software aktual dhe të përparuar si psh Leica, që për faktin që kështu e ofron prodhuesi, rezultojnë të barasvlershëm. Kjo përbën diskriminim për produktin e zhvilluar dhe diskriminim për produktin e vjetër dhe dënohet nga disa nene të LPP04/L-042, si neni 1, 7 dhe sidomos 48.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 4

Lidhur me pretendimin ankimor, ekspertit shqyrtues sqaron se sa i përket kërkesës së autoritetit kontraktues se çdo softwer duhet të jetë i hapur në të gjitha funksionalitet ekspertit shqyrtues mendon se kjo kërkesë nuk përbën ndonjë shkelje sepse nuk dëshmohet se ndonjë prodhues nuk e ka ndonjë funksionalitet madje nuk dëshmohet me asnjë dokument që edhe vetë prodhuesi i ofruar nga operatori ekonomik ankues që nuk posedon të gjitha funksionalitetet e hapura.

Në bazë të sqarimeve të specifikuara më lartë për mendimin e ekspertit shqyrtues pretendimi ankimor 4 i ankuesit është i pa bazuar.

Në përgjithësi konstatohet se pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues nuk i referohen në asnjë vend shkeljes se ndonjë standardi në lidhje me specifikimet teknike apo të ndonjë parametri teknik që prodhuesi i caktuar është diskriminuar apo është favorizuar.

Mendimii ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura ekspertit shqyrtues i propozon panelit shqyrtues: ankesa e Operatorit Ekonomik ankues DWH-KOSVA SH.P.K të refuzohet si e PA BAZUAR, Ti lejohet Autoriteti kontraktues të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit sipas ndryshimeve të bëra në specifikimet teknike të datës 18.10.2022.

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe analizimit të gjitha provave të lëndës, konstatohet se seanca dëgjimore mund të mbahet pa prezencën e palëve konform nenit 24 paragrafi 1 i Rregullores së Punës së OSHP-së 01/2020.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët pohimet, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij Paneli.

Paneli shqyrtues me marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues

Vedat POTERQOI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale- Administrativ në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK-së Komuna e Gjakovës

1x1 DWH-Kosova Shpk”me seli në Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.